



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

SEKTORI MËSIMOR & KURRIKULËS, INFORMIMIT TË STUDENTËVE,
KËSHILLIMIT TË KARRIERËS DHE ALUMNI

Procedurat pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë

Viti Akademik 2024-2025 / Kreu IV		Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit
1.	Kreu IV, pika 1 Kandidatët që kërkojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, kanë të drejtë të aplikojnë pranë IAL-ve, deri në 5 pesë programe studimi, pranë institucioneve të arsimit të lartë brenda datës së përcaktuar në kalendar.	02 – 03 shtator 2024
2.	Kreu IV, pika 10 IAL-të shpallin në vende të dukshme listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi brenda datës së përcaktuar në kalendar.	Brenda datës: 17 shtator 2024
3.	Kreu IV, pika 11 Çdo aplikim për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohet nga komisioni i ngritur nga IAL-ja Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi. Të dhënat e të gjithë kandidatëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit shpallen në mjediset e fakulteteve të UART, si dhe në faqen zyrtare www.uart.edu.al , e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës të Udhëzimit nr.12, dt. 30.06.2023.	Brenda datës: 23 shtator 2024
4.	Kreu IV, pika 12 IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar në kalendar. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të pranimit për programin përkatës të studimit. Lista përmban pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.	Brenda datës: 24 shtator 2024
5.	Kreu IV, pika 14 IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës së përcaktuar në kalendar.	Brenda datës: 27 shtator 2024
6.	Kreu IV, pika 15 Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore në datat e përcaktuara në kalendar, sipas dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara pas vijës së kuqe në listë.	07 – 11 tetor 2024
7.	Kreu IV, pika 15 Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara pas vijës së kuqe në listë.	18 tetor 2024